



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 97/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.SH. “Vëllezërit Berisha” me numër të biznesit 70739119 dhe seli në Prishtinë, rr. “Ahmet Krasniqi”, lagja Arbëria 3, kundër debitorit N.N.P “Standard Plus” me numër të biznesit 70502917 dhe seli në Banjë, Komuna Malishevë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.K., avokat me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 64/18, i lejuar me datë 22.05.20218, nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 20.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.N.P “Standard Plus” me numër të biznesit 70502917, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 64/18, i lejuar me datë 22.05.20218, nga Përmbartuesi Privat Myjesere Mujku ANULOHET, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 200613, e datës 20.06.2013, ka caktuar përmbartimin sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr. 64/2018, të datës 22.05.2028, me të cilin është lejuar përmbartimi ndaj debitorit për pagesën e borxhit sipas faturës në vlerë prej EUR 11,600.00, me kamatë ligjore, si dhe për pagesën e shpenzimeve procedurale.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetim se kërkesa e cila buron nga dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri është përfshi në parashkrim në kuptim të nenit 374 të LMD-së. Më tej, ka shtuar se dokumenti në fjalë nuk është pranuar, nënshkruar apo vulosur nga ana e debitorit e gjithashtu edhe kontrata e paraqitur si provë së bashku me propozim për përmbartim është e

panëshkruar dhe e pavulosur nga ana e debitorit. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje “LPP”) dhe nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, ndërsa procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkaket si në vijim:

Gjykata, ka shqyrtuar pretendimet e debitorit në raport me parashkrimin e kërkesës së kreditorit, dhe gjeti se Fatura nr. 200613, është lëshuar dhe është bërë e arritshme për pagesë me datë 20.06.2013, ndërsa propozimi për përmbartim në raport me këtë faturë nga ana e kreditorit është paraqitur me datë 22.05.2018, dhe rrjedhimisht borxhi i cili buron nga kjo faturë mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, është përfshirë në parashkrim, kjo në përputhje me nenin 355, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili përcakton se: *“Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”*.

Mbi këtë bazë, gjykata gjeti se prapësimi i debitorit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 të LPP-së, i cili përcakton se: *“...prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbartues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, përkatësisht fatura mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbartim e mbi bazën e të cilit është lejuar urdhri përmbartimor është përfshi në parashkrim, dhe si e tillë nuk mund t'i nënshtrohet përmbartimit, rrjedhimisht edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit duhet të anulohet.

Meqenëse gjykata ka aprovuar prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi që procedura përmbartimore në këtë çështje të përfundohet.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71, paragrafi 1, pika 1.10 dhe 73 të LPP-së, nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 97/22, datë 20.09.2023

Gjyqtari

Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.